




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



**Procesverbal nga takimi me qytetarët e
Rahovecit, me fokus përfaqësuesit e ojq-ve,
bizneseve, fermerëve, rinisë komuniteteve
përfaqësues të shkollave dhe grupeve të interesit.**

Afrim Limani: Është e arsyeshme që ky takim të mbahet edhe pse pjesëmarrja e qytetarëve është jo e kënaqshme. Të nderuar pjesëmarrës! Më lejoni që në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa t'ju shpjegojë buxhetin komunal për vitin 2027. Sipas Qarkores së Parë Buxhetore, që është dokument i rëndësishëm financiar i përcaktuar me Ligjin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe e përcakton hisen buxhetore për çdo komunë të Republikës së Kosovës. Sipas këtij dokumenti të rëndësishëm, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€ dhe ndahet sipas programeve. Në administratë: 9.946.000 dhe kur bëjmë një krahasim me vitin aktual, kemi rritje të buxhetit prej 778.000€. Në arsim: 634.305 dhe kur bëjmë krahasim me vitin 2026, kemi një zvogëlim prej 660.000. Në shëndetësi: 2.323.000 dhe kur bëjmë krahasim me vitin aktual, kemi një rënie prej 36.000. E falënderoj ekipin tim të financave, që brenda një afati shumë të shkurtër kemi bërë një punë shumë intensive. Në kategori ekonomike, përafërsisht buxheti duhet të jetë kështu: Pozicioni i pagave: 12.919.000€, mallra dhe shërbime 2.821.000, shpenzime komunali 440.00, subvencione 1.000.000 dhe investime kapitale 4.523.000, 374.000 euro më pak në vitin 2027 se sa në vitin 2026. Të nderuar pjesëmarrës, si rezultat i kontratës kolektive jemi në një krizë financiare, krejt kjo si pasojë e kontratës kolektive, e cila deri më tani i ka tërhequr 3.5 milionë. Buxheti i arsimit gjithashtu ka ndikuar që ulje të buxhetit, sepse mungesa e nxënësve llogaritet sipas formulës. Drejtpërdrejt në zvogëlimin e buxhetit është edhe numri më i vogël i popullsisë, pra jemi 14.000 banorë më pak se sa në regjistrimin e parafundit. Ju ftoj t'i paraqitni pyetjet dhe kërkesat e juaja rreth këtij dëgjimi publik.

Muharrem Morina: Përshëndetje! Sot po flas në cilësinë e kryetarit të fshatit Dejnë! Drejtor, kërkesat e përvitshme të fshatit tonë, a janë shqyrtuar dhe a ka shpresë për realizimin e projekteve në 2027? Një pyetje tjetër rreth çështjes së arsimit: a keni ndonjë plan që të dilni prej kësaj situata jo të mirë të krijuar nga kontrata kolektive?

Afrim Limani: Faleminderit, Muharrem! Si komision për planifikim të buxhetit i procesojmë të gjitha kërkesat dhe i shqyrtojmë gjithnjë duke u bazuar në kapacitetin buxhetor të komunës. Në anën tjetër, buxheti asnjëherë nuk është i mjaftueshëm e sidomos për sivjet që jemi zero për shkak të kontratës kolektive. Sa i përket çështjes në fjalë, pra të arsimit, e kemi në plan që në vitin 2027 t'i zvogëlojmë klasët mësimore.

Setki Kryeziu: Përshëndetje, jam drejtor i shkollës "Hamëz Thaqi" Xërxë, në të cilën kemi probleme me ngrohje, respektivisht me kalldajë, e cila është e vjetër 15 vjet. Kërkojmë zgjidhje konkrete para muajit tetor. Gjithashtu, kemi nevojë edhe për ndërhyrje në dysheme, si dhe në dyer të klasave.

Afrim Limani: Faleminderit, Setki! Kemi pasur probleme të tilla me ngrohje edhe sa kam qenë drejtor i Arsimit, por falë Jeton Thaqit, të cilin e falënderoj publikisht, kemi bërë zgjidhje në këtë çështje. Besoj që sivjet do t'i zgjidhim këto probleme dhe në vitin e ardhshëm nuk do të kemi probleme të tilla. Nëse edhe dikush tjetër nuk ka pyetje, atëherë këtë takim e quaj të mbyllur. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje!

Procesmbajtës;


Albion Krasniqi

